



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bordi i Administrimit

Nr. 857 Prot

Shkodër, me 24.02 2026

V E N D I M

Nr. 78 datë 24.02 2026

" Për miratimin e udhëzuesit "Mbi procedurën e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit, miratimit dhe rimbursimit të finacimit të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të USH-së"


Bazuar në ligjin e AL nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe të Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 3, germa d; Statutin e USH-se neni 5, pika 3 germa c ;neni 17, pika 6 germa r dhe me vendim të Senatit Akademik nr.70 datë 19.02.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 24.02.2026 me katër vota pro, dy kundër

Vendosi:

1. Miratimin e udhëzuesit "Mbi procedurën e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit, miratimit dhe rimbursimit të finacimit të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të USH-së sipas materialit bashkengjitur vendimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrian LEKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

UDHËZUES

MBI

**PROCEDURËN E APLIKIMIT, SHQYRTIMIT, VLERËSIMIT, MIRATIMIT DHE
RIMBURSIMIT TË FINANCIMIT TË BOTIMEVE DHE PJESËMARRJES NË
KONFERENCA TË STAFIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS
"LUIGJ GURAKUQI"**

SHKODËR, 2026

Tabela e përmbajtjes

KREU I.....	3
FINANCIMI I BOTIMEVE DHE Pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të ush.....	3
1.1 Hyrje.....	3
1.2 Qëllimi.....	3
1.3 Objektivat.....	3
1.4 Kriteret e pranueshmërisë.....	3
KREU II.....	5
PROCEDURAT E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE Përzgjedhjes së stafit akademik që përfiton financimin.....	5
2.1 Shpallja e thirrjes për shprehje interesi	5
2.2 Dokumentacioni i shprehjes së interesit.....	7
2.3 Afati i dorëzimit të shprehjes së interesit	7
2.4 Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e fituesve	7
2.5 Njoftimi i fituesve të financimit.....	7
KREU III.....	9
ASPEKTE FINANCIARE MBI FINANCIMIN E BOTIMEVE DHE Pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të ush-së.....	9
3.1 Rregulla për dokumentacionin për rimbursim të pjesëmarrjes në konferenca	9
3.3 Marrja në shqyrtim e kërkesave për rimbursim dhe dokumentacionit shoqërues	12
3.4 Rimbursimi i shpenzimeve nga USH-ja: Veprimet financiare.....	12
SHTOJCA 1.....	14
SHTOJCA 2.....	15
SHTOJCA 3.....	16
SHTOJCA 4.....	17
SHTOJCA 5.....	21
SHTOJCA 6.....	24

KREU I

FINANCIMI I BOTIMEVE DHE PJESËMARRJES NË KONFERENCA TË STAFIT AKADEMIK TË USH

1.1 Hyrje

Zhvillimi i veprimtarisë shkencore në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” mbështetet në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e USH-së, në qëllimin dhe objektivat e përcaktuara në Strategjinë e USH-së për kërkimin shkencor, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të USH-së nr. 79 të datës 25.3.2022, “Për miratimin e strategjive sektoriale në USH”. Kjo strategji synon të realizojë përparimin shkencor në koncept, teknologji dhe metodologji dhe zhvillimin e politikave kërkimore në përputhje me programet shtetërore dhe rajonale. Sa më sipër, USH-ja në këtë strategji ka përcaktuar edhe fushat prioritare kërkimore.

1.2 Qëllimi

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përmes mbështetjes financiare të stafit akademik, përmes mbulimit të shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferenca/kongrese/simpoziume dhe botimit në revista prestigjioze brenda dhe jashtë vendit, synon një nxitje të kërkimit shkencor dhe inovacionit në njësitë kryesore dhe ato bazë sipas prioriteteve të vetë universitetit, por edhe bazuar në fushat prioritare kombëtare dhe në përputhje me zhvillimet rajonale dhe evropiane të kërkimit shkencor.

1.3 Objektivat

- Rimbursimi i shpenzimeve të tarifës së pjesëmarrjes (*fee*), biletave të udhëtimit dhe faturave të akomodimit, për stafin akademik të USH-së që marrin pjesë në konferenca/kongrese/simpoziume brenda dhe jashtë vendit.
- Rimbursimi i shpenzimeve të tarifës së botimit në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit për stafin akademik të USH-së

1.4 Kriteret e pranueshmërisë

Të drejtën për të aplikuar për rimbursim të pjesëmarrjes në konferenca/kongrese/simpoziume brenda dhe jashtë vendit, si edhe për botime në revista brenda dhe jashtë vendit e ka i gjithë stafi akademik i punësuar me kohë të plotë në USH.

Anëtarët e stafit akademik me kohë të plotë të cilët janë duke përfituar leje akademike, ose janë duke ndjekur studimet doktorale jashtë vendit dhe nuk janë të angazhuar me kohë të plotë në USH, përjashtohen nga kjo e drejtë rimbursimi.

Në rastet kur vlera e pagesës së pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium ose ajo e botimit përlllogaritet bazuar në numrin e bashkautorëve dhe bashkautorët janë nga institucione jashtë USH-së, atëherë çdo vlerë e cila i shtohet pagesës për praninë e këtij bashkautori nuk kërkohet si financim për rimbursim në USH.

Kriteret specifike të pranueshmërisë rregullohen bazuar në:

- Vendimin e Bordit të Administrimit të USH-së nr. 220 datë 29.09.2023 (nr. 2907 prot. datë 29.09.2023) me objekt *“Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’”*;
- Vendimin e Bordit të Administrimit të USH-së nr. 140 datë 28.04.2025 (nr. 1620 prot. datë 28.04.2025) me objekt: *“Për kryerjen e disa ndryshimeve në vendim të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së 207 datë 25.09.2023 “Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’”*;
- Vendimin e Bordit të Administrimit të USH-së nr. 200 datë 01.07.2025 (Nr. 2322 prot. Datë 01.07.2025) me objekt *“Për saktësim në vendim të BA-së nr. 140 datë 28.04.2025 dhe vendimit të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së nr. 207 datë 25.09.2023 Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’”*.

Secili anëtar i stafit akademik duhet t’i referohet këtyre vendimeve në momentin e kërkesës për mbulim shpenzimesh për përfitimin e këtyre rimbursimeve.

KREU II

PROCEDURAT E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË STAFIT AKADEMIK QË PËRFITON FINANCIMIN

2.1 Shpallja e thirrjes

Në bazë të kritereve të përcaktuara, njësia kryesore, në periudhat dhjetor, prill dhe shtator shpall thirrjen për kërkesat për mbulim shpenzimesh të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca/kongrese/simpoziume të stafit akademik me kohë të plotë.

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të stafit akademik të cilëve do t'i mbulohen shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca/kongrese/simpoziume ose për botimet e tyre, do të përcaktohen nga njësia kryesore bazuar në:

1. Prioritetet e njësisë kryesore bazuar në nevojat aktuale si p.sh.
 - financimi i anëtarëve të stafit me titull prof. as. për të përmbushur kriteret për titullin profesor, për të kontribuar në këshillin institucional të profesorëve.
 - financimi i anëtarëve të stafit me gradën doktor, për të përmbushur kriteret për titullin profesor i asociuar.
 - financimi i anëtarëve të stafit që janë në proces doktrate.
2. Shtëpitë botuese të revistave ku botohen artikujt për rimbursim si p.sh.
 - i jepet përparësi artikujve të botuar nga revista të menaxhuara nga shtëpi botuese me eksperiencë dhe kualitative¹ si p.sh:
 - Nivel 3 – Shtëpi botuese me ndikim shumë të lartë dhe të qëndrueshëm global si Boydell & Brewer, Brill, Cambridge University Press, Columbia University Press, Cornell University Press, De Gruyter, Harvard University Press (përfshirë imprint-in Belknap Press), Johns Hopkins University Press, MIT Press, Oxford University Press (përfshirë imprint-in Clarendon Press), Palgrave Macmillan, Polity Press, Princeton University Press, Routledge, SAGE Publications, Stanford University Press, University of California Press, University of Chicago Press, Yale University Press etj.
 - Nivel 2 – Shtëpi botuese kombëtare ose ndërkombëtare udhëheqëse, me shtrirje shumë të gjerë dhe ndikim të fortë akademik si Allen & Unwin, Allen Lane (Penguin), Ashgate, Basic Books, Berg (Oxford), Berghahn Books, Blackhall Publishing, Blackwell, Bloomsbury Academic, Brepols, Cork University Press, Duke University Press, Edinburgh University Press, Edward Elgar Publishing, Equinox Publishing, Fordham University Press, Franz Steiner Verlag, Gill & Macmillan, Harrassowitz Verlag, Hart Publishing, Hurst Publishers, I.B. Tauris, Indiana University Press, Intellect Books, Irish Academic Press, Jessica Kingsley Publishers, John Wiley & Sons, Kluwer Academic Publishers, Kluwer Law International, Lexington Books, LIT Verlag, Liverpool University Press, Lynne Rienner Publishers, M.E. Sharpe, Manchester University Press, Methuen, Max Niemeyer Verlag, Mohr Siebeck, New Island Books, Nova Science Publishers,

¹ <https://phdtalks.org/2022/06/top-academic-journal-publishers.html>

National University of Ireland Press, New York University Press (NYU Press), Ohio State University Press, Open University Press, Pennsylvania State University Press, Peter Lang, Pluto Press, Praeger, Prentice Hall, Random House, Rodopi, Royal Irish Academy Press, Rowman & Littlefield, Rutgers University Press, Springer, St. Martin's Press, SUNY Press, Round Hall / Sweet & Maxwell, Syracuse University Press, Tamesis, Taylor & Francis, University of Texas Press, UCD Press, UCL Press, University of Illinois Press, University of Michigan Press, University of Pennsylvania Press, University of Minnesota Press, Vandenhoeck & Ruprecht, Verso Books, Westview Press, Zed Books etj.

➤ Nivel I – Shtëpi botuese të rëndësishme, më të specializuara, që prodhojnë kërkim shkencor me cilësi të lartë dhe proces rigoroz rishikimi si Anthem Press, Aschendorff Verlag, Barcelona Publishers, Bristol University Press, Clarus Press, Dublin Institute for Advanced Studies, Four Courts Press, Irish Manuscripts Commission, Irish Texts Society, Legenda (Oxford), Longman (Pearson Longman), Reaktion Books, Schwabe Verlag, Scribner (imprint i Simon & Schuster), T.M.C. Asser Press, University of Toronto Press, University of Westminster Press, Woodhead Publishing etj.

– i jepet përparësi artikujve të botuar në revista të indeksuara në *web of science* dhe SCOPUS.

3. Tipologjinë e konferencës si p.sh.

– I jepet përparësi konferencave periodike, të organizuara në mënyrë të vazhdueshme nga institucione akademike ose kërkimore të njohura, ose partnere të USH-ës, me historik të dokumentuar dhe reputacion shkencor të konsoliduar², përkundrejt konferencave të organizuara vetëm një herë (*one-off conferences*);

– I jepet përparësi konferencave/kongreseve/simpoziumeve që organizohen drejtpërdrejt, ose në partneritet, nga universitete të renditura në *Times Higher Education (THE) World University Rankings by Subject*, sipas listës më të fundit të publikuar në periudhën e aplikimit³

4. Barazinë dhe trajtimin e barabartë të gjithë stafit nga të gjitha njësitë si p.sh.

– Kur shfaqet e nevojshme njësi kryesore vendos edhe kriteret përjashtuese për të mos lejuar favorizimin për dy vite rresht të njëjtëve aplikues, për t'i dhënë mundësinë e barabartë të gjithë stafit për të përfituar nga ky fond.

– Shpërndarja e fondit të realizohet në mënyrë proporcionale në mes njërive bazë përbërëse të së njëjtës njësi kryesore.

5. Bashkautorësisë dhe numrin e citimeve p.sh.

– I jepet përparësi aplikimeve të cilat rendisin si bashkautor të paktën 2 pedagogë të brendshëm të USH-së;

– I jepet përparësi aplikimeve të cilat citojnë të paktën 2 punime të realizuara nga pedagogë të brendshëm të USH-së.

6. Fondin në dispozicion.

² <https://www.timeshighereducation.com/world-reputation-rankings>

³ <https://www.timeshighereducation.com/world-university-rankings/by-subject>

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të stafit akademik për mbulimin e shpenzimeve përcaktohen në thirrjen e parë të vitit buxhetor për mbulim shpenzimesh për botime dhe pjesëmarrje në konferenca/kongrese/simpoziume dhe mbeten të njëjtat gjatë gjithë atij viti buxhetor.

Gjatë një viti buxhetor do të realizohen 3 thirrje:

- Faza e parë, jo më vonë se data 1 dhjetor
- Faza e dytë, jo më vonë se data 15 prill
- Faza e tretë, jo më vonë se data 15 shtator

Thirrjet për kërkesat për mbulim të shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferenca/kongrese/simpoziume dhe botime në revista shkencore do t'i dërgohen në formë elektronike nga njësia kryesore, çdo anëtar i të stafit akademik të punësuar me kohë të plotë në atë njësi kryesore dhe për dijeni zv. Rektorit të Kërkimit Shkencor.

2.2 Dokumentacioni për kërkimin e mbulimit të shpenzimit

Anëtarët e stafit kërkojnë miratimin për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në konferenca/kongrese/simpoziume përmes plotësimit të formularit në shtojcën 1, ndërsa për botime në revista të formularit në shtojcën 2.

Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në konferenca/kongrese/simpoziume realizohet gjithmonë përpara realizimit të konferencës, ndërsa për rimbursimin e botimit në revista, pasi artikulli është botuar në revistë.

2.3 Afati i dorëzimit të kërkesës për mbulim të shpenzimeve

Anëtarët e stafit të interesuar brenda 15 ditëve kalendarike nga shpallja e thirrjes, dhe jo më vonë se 15 dhjetor, 30 prill dhe 30 shtator, dërgojnë në rrugë elektronike pranë njësisë kryesore formularin e shtojcës 1 ose 2, në varësi nëse kërkojnë mbulim të shpenzimeve për pjesëmarrje në konferencë/kongres/simpozium apo të botimit në revista.

2.4 Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e fituesve

Në mbledhjen e parë të komisionit të ngritur nga Dekani pranë njësisë kryesore, pas përfundimit të procesit të mbledhjes së aplikimeve për kërkesat për mbulim të shpenzimeve, dhe jo më vonë se data 10 (janar, maj dhe tetor), bëhet vlerësimi i të gjithë aplikimeve të ardhura në njësitë kryesore.

Bazuar në prioritetet e përcaktuara nga secila njësi kryesore dhe fondin në dispozicion, njësi kryesore përcakton listën e anëtarëve të stafit akademik aplikues që parashikohet t'u mbulohen nga USH-ja shpenzimet për pjesëmarrjen e tyre në konferenca/kongrese/simpoziume që do të realizohen në periudhën në vijim dhe botimet e realizuara deri në atë moment.

2.5 Njoftimi i fituesve të financimit

Secili aplikues do të njoftohet me rrugë elektronike nga njësi kryesore, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit, në lidhje me vendimin për mbulim të shpenzimeve të parashikuara për pjesëmarrjen e tij/saj në konferencë/kongres/simpozium, ose botimin në revistë.

2.6 Ankimimi

Aplikuesit të cilët nuk e kanë përfituar mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferenca /kongrese/simpoziume apo botimit në revista shkencore kanë të drejtën e ankimit brenda 5 ditëve punë nga shpallja e vendimit. Ankimimi i vendimit i paraqitet drejtuesit të njësisë kryesore i cili ngrë një komision *ad-hoc* për shqyrtimin e ankesave, në përbërje të të cilit duhet të jetë edhe një përfaqësues i caktuar nga rektori. Komisioni *ad-hoc* del me një vendim përfundimtar brenda 5 ditëve punë.

UNIVERSITETI
-RI

KREU III

ASPEKTE FINANCIARE MBI FINANCIMIN E BOTIMEVE DHE PJESËMARRJES NË KONFERENCA TË STAFIT AKADEMIK TË USH-SË

3.1 Rregulla për dokumentacionin për rimbursim të pjesëmarrjes në konferenca /kongrese/simpoziume

3.1.1 Hapat e aplikimit për rimbursim

Stafi akademik i cili ka fituar të drejtën për të përfituar rimbursim për shpenzimet e pjesëmarrjes në konferencë duhet që:

1. Për pjesëmarrje fizike në konferencë/kongres/simpozium të paraqesë në rrugë elektronike pranë Drejtorisë së Fondit të Investimeve dhe Shërbimeve (DFISH), të paktën 2 javë para datës së udhëtimit:
 - a. Të dhënat për udhëtimin:
 - Emrin e personit që udhëton;
 - Datën e nisjes;
 - Vendin e nisjes;
 - Orarin preferencial të nisjes;
 - Datë e kthimit;
 - Vendin e kthimit;
 - Orarin preferencial të kthimit;
 - b. Njoftimin e fitimit të financimit (shiko pikën 2.5);
 - c. Njoftimin e pranimit të prezantimit nga organizatorët e konferencës/kongresit /simpoziumit.
2. Pasi ka realizuar pjesëmarrjen e tij në konferencë/kongres/simpozium duhet të paraqesë:
 - a. Pranë njësisë kryesore një relacion për mbarëvajtjen e pjesëmarrjes në konferencë /kongres/simpozium (shtojca 3) brenda dy javëve nga pjesëmarrja në konferencë /kongres/simpozium;
 - b. Pranë Drejtorisë së Kërkimit shkencor dhe Ndërkombëtarizimit (DKSHN) kërkesën për rimbursim të shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium (shtojca 4) brenda një muaji nga përfundimi i konferencës/kongresit/simpoziumit.

3.1.2 Dokumentacioni për rimbursim (shoqëruet i shtojcës 4)

Për rimbursimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium stafi akademik që kërkon të rimbursohet duhet të paraqesë dokumentin origjinal shoqëruar me dy kopje të secilit dokument sikurse shpjegohet në vijim.

3.1.2.1 Rimbursim i tarifës së pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium

Për rimbursimin e tarifës së pjesëmarrjes (*fee*) aplikanti për rimbursim duhet të paraqesë:

1. Faturë për tarifën e pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium.
 - Fatura duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur nga institucioni që e lëshon, ose e shoqëruar me barkod;

- Fatura duhet të paraqesë qartë institucionin që organizon konferencën/kongresin/simpoziumin dhe lëshon faturën dhe t'i adresohet përftuesit të rimbursimit (autorit të parë ose të dytë të prezantimit);
- Fatura duhet të përshkruhet si pagesë tarife për konferencën /kongresin/simpoziumin.

2. Transfertë/Urdhër pagesë për tarifën e pjesëmarrjes në konferencë.

- Ky dokument nuk është i nevojshëm kur pagesa e faturës bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/krediti);
- Transferta/Urdhërpagesa duhet të jetë gjithmonë me emrin e përftuesit të rimbursimit (autorit të parë ose të dytë të prezantimit);
- Në transfertë/ urdhërpagesë duhet të dalë qartë si përftues i shumës institucioni që organizon konferencën ose një përfaqësues ligjor i tij;
- Transferta/Urdhërpagesa duhet të ketë përshkrimin "Pagesë tarifë pjesëmarrje në konferencën *akronimi i konferencës* për *emri dhe mbiemri i autorit të parë ose të dytë*"
- Transferta/Urdhërpagesa duhet të jetë me firmë dhe vulë të njomë të bankës.

3. Nxjerrje llogarie (*Statement* nga banka)/ *screenshot* i pagesës

- Ky dokument është i domosdoshëm vetëm kur pagesa e faturës bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/krediti);
- Ky dokument duhet me vulë dhe firmë të njomë.

3.1.2.2 Rimbursimi i shpenzimeve të udhëtimit të pjesëmarrjes në konferencë/kongres /simpozium

Për rimbursimin e shpenzimeve të udhëtimit të pjesëmarrjes në konferencë/kongres /simpozium, stafi akademik që kërkon rimbursim duhet të paraqesë:

Për udhëtim me avion:

Në momentin e paraqitjes së kërkesës për rimbursim stafi akademik i cili ka fituar të drejtën për rimbursim të shpenzimeve dhe që ka përfituar nga institucioni biletën e udhëtimit me avion, duhet të paraqesë bashkë me dokumentet e tjera të udhëtimit edhe:

1. *Boarding pass*

- Të ikjes dhe kthimit
- Dokumenti duhet të ketë emrin e përftuesit të financimit.

Për udhëtim me autobus/treni

1. Biletë autobusi/treni
2. Në rastin kur bileta nuk tregon çmimin e shërbimit atëherë duhet të dorëzohet edhe fatura e biletës.

3.1.2.3 Për vërtetimin e pjesëmarrjes në konferencë

Aplikanti duhet të vërtetojë që ka marrë pjesë në konferencë duke paraqitur:

1. Të paktën një nga dokumentet e listuar më poshtë:
 - Certifikatë pjesëmarrjeje;
 - Listë-prezencë;
 - Agjendë/Program të konferencës/kongresit/simpoziumit;
 - Tabelën e përmbajtjes së librit të *proceedings*/abstrakteve ose versionin e printuar nga platforma e konferencës//kongresit/simpoziumit.
2. Faqet e plota të prezantimit të mbajtur prej tij/saj në librin e *proceedings*/abstrakteve, ose të programin, ku USH-ja prezantohet si institucioni i përkatësisë (*affiliation*).

3.2 Rregulla për dokumentacionin për rimbursim të botimit në revista

3.2.1 Hapat e rimbursimit

Stafi i cili është përzgjedhur si fitues i të drejtës për rimbursim, duhet të paraqesë pranë DKSHN-së kërkesën për rimbursim të shpenzimeve të botimit në revistë shkencore (shtojca 5).

3.2.2 Dokumentacioni për rimbursim (shoqërues i shtojcës 5)

3.2.2.1 Rimbursim i tarifës së botimit

Për rimbursim e tarifës së botimit aplikanti për rimbursim duhet të paraqesë:

1. Faturë për tarifën e botimit në revistë.
 - Fatura duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur nga institucioni që e lëshon, ose e shoqëruar me barkod;
 - Fatura duhet të paraqesë qartë institucionin që boton revistën dhe lëshon faturën dhe t'i adresohet përfituesit të rimbursimit (autorit të parë ose të dytë të artikullit);
 - Fatura duhet të përshkruhet si pagesë tarife për botim në revistën përkatëse.
2. Transferta/Urdhër pagesë për tarifën e botimit
 - Ky dokument nuk është i nevojshëm kur pagesa e faturës bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/kreditit);
 - Transferta/Urdhërpagesa duhet të jetë gjithmonë me emrin e përfituesit të financimit (autori i 1 ose i 2);
 - Në transfertë/ urdhërpagesë duhet të dalë qartë si përfitues i shumës institucioni që boton revistën ose një përfaqësues ligjor i tij;
 - Transferta/Urdhërpagesa duhet të ketë përshkrimin “Pagesë tarifë botimi në revistën ***akronimi i revistës*** për ***emri dhe mbiemri i autorit të parë/dytë***”;
 - Transferta/Urdhërpagesa duhet të jetë me firmë dhe vulë të njomë të bankës.
3. Nxjerrje llogarie (*Statement* nga banka)/ *screenshot* i pagesës
 - Ky dokument është i domosdoshëm vetëm kur pagesa e faturës bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/kreditit)
 - Ky dokument duhet me vulë dhe firmë të njomë.

3.2.2.2 Për vërtetimin e botimit

Për rimbursimin e shpenzimeve të botimit, kërkuesi i rimbursimit duhet të paraqesë:

1. Kodin DOI (*Digital Object Identifier*) të artikullit.
2. Kopertinën dhe tabelën e përmbajtjes e numrit të revistës ku gjendet artikulli (nëse aplikohet nga revista);
3. Faqet e plota të artikullit të botuar në revistë ku USH-ja prezantohet si institucioni i përkatësisë (*affiliation*).

3.3 Marrja në shqyrtim e kërkesave për rimbursim dhe dokumentacionit shoqërues

Kërkesat për rimbursim mbledhen dhe merren në shqyrtim nga DKSHN-ja të paktën çdo dy javë. Kontrolli konsiston në përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Bordit të Administrimit të USH-së nr. 220 datë 29.09.2023 (nr. 2907 prot. datë 29.09.2023) me objekt “Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’”; Vendimin e Bordit të Administrimit të USH-së nr. 140 datë 28.04.2025 (nr. 1620 prot. datë 28.04.2025) me objekt: “Për kryerjen e disa ndryshimeve në vendim të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së 207 datë 25.09.2023 “Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’”; Vendimin e Bordit të Administrimit të USH-së nr. 200 datë 01.07.2025 (Nr. 2322 prot. Datë 01.07.2025) me objekt “Për saktësim në vendim të BA-së nr. 140 datë 28.04.2025 dhe vendimit të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së nr. 207 datë 25.09.2023 Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’” dhe detajet e këtij Udhëzuesi.

Përmes një relacioni, kërkesat e ardhura për rimbursim të realizuara në përputhje me vendimet në fuqi të BA-së dhe këtij udhëzuesi, shoqëruar me faturat përkatëse, si edhe emrat dhe detajet e nevojshme për aplikimet të cilat nuk rimbursohen i kalojnë për miratim Zv. Rektorit të Kërkimit Shkencor. Zv. Rektori, për dijeni të Rektorit, e përcjell pranë Administratorit dokumentacion e kërkesave për t’u rimbursuar dhe tek aplikuesi që nuk rimbursohet vendimin për mos-rimbursim.

Gjatë fazës së shqyrtimit të dokumentacionit, nëse konstatohen nevoja për plotësim, DKSHN kërkon tek aplikuesi përmes e-mailit plotësimin e dokumentacionit.

3.4 Rimbursimi i shpenzimeve nga USH-ja: Veprimet financiare

Me rimbursimin e shpenzimeve do të merret Drejtoria e Financave dhe Buxhetit pranë USH-së. Kjo drejtori, maksimumi brenda 1 muaji, realizon urdhër-shpenzimet për rimbursimin e shpenzimeve të paraqitura përmes kërkesave të përcjella nga zv. Rektori i Kërkimit Shkencor.

3.5 Njoftimi i njësive kryesore për fondin në dispozicion

Përpara çdo shpallje thirrje, në fillim të muajve prill, shtator dhe dhjetor, Administratori duhet të përcjellë pranë njësive kryesore dhe për dijeni të Rektorit, zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe DKSHN-së një përmbledhëse të fondit të shpenzuar nga njësia kryesore gjatë asaj periudhe, sipas shtojcës 6.

3.6 Ankimimi

Aplikuesit të cilët nuk e kanë përfituar rimbursimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferenca /kongrese/simpoziume apo botimit në revista shkencore kanë të drejtën e ankimimit brenda 5 ditëve punë nga njoftimi. Ankimimi i vendimit i paraqitet Rektorit i cili ngre një komision *ad-hoc* për shqyrtimin e ankesave. Komisioni *ad-hoc* del me një vendim përfundimtar brenda 5 ditëve punë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I EMRI I FAKULTETIT

Shkodër, më _____

Lënda: Kërkesë për mbulim të shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferencën/kongresin/simpoziumin **"*Akronimi i konferencës/kongresit/simpoziумit*"**

TITULLI/GRADA EMRI MBIEMRI

DEKAN

FAKULTETI I *EMRI I FAKULTETIT*

Në vijim të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 220 datë 29.09.2023 (nr. 2907 prot. datë 29.09.2023) me objekt "Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 140 datë 28.04.2025 (nr. 1620 prot. datë 28.04.2025) me objekt: "Për kryerjen e disa ndryshimeve në vendim të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së 207 datë 25.09.2023 "Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 200 datë 01.07.2025 (Nr. 2322 prot. Datë 01.07.2025) me objekt "Për saktësim në vendim të BA-së nr. 140 datë 28.04.2025 dhe vendimit të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së nr. 207 datë 25.09.2023 Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'" dhe Udhëzuesit Nr. ____ datë __/__/2026 me objekt "Udhëzues mbi procedurën e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të financimit të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", si dhe detyrimeve që lindin për kërkesën e mbulimit të shpenzimeve për pjesëmarrje në konferenca/kongrese/simpoziume, kërkoj miratim për të marrë pjesë në konferencën **"*Titulli i plotë i konferencës/kongresit/simpoziумit*"** që do të organizohet ***me datë DD.MM.VVVV*** ose në muajin ***muaji*** në ***emri i qytetit (Shteti)*** nga ***Emri i institucionit qe e organizon*** me punimin **"titulli i punimit"** abstraktin e të cilit e gjeni bashkëngjitur këtij dokumenti. Për pjesëmarrjen në këtë konferencë parashikohet të nevojitet mbulimi nga USH i një shpenzimi prej rreth ***shuma e përafërt e shpenzimit që parashikohet dhe monedha***.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Titulli. Grada. Emri Mbiemri

Pedagog pranë Departamentit të ***Emri i departamentit***

Fakulteti i ***Emri i Fakultetit***



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I EMRI I FAKULTETIT

Shkodër, më _____

Lënda: Kërkesë për mbulim të shpenzimeve të botimit të artikulli në **"*Akronimi i revistës*"**

TITULLI/GRADA EMRI MBIEMRI

DEKAN

FAKULTETI I *EMRI I FAKULTETIT*

Në vijim të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 220 datë 29.09.2023 (nr. 2907 prot. datë 29.09.2023) me objekt "Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 140 datë 28.04.2025 (nr. 1620 prot, datë 28.04.2025) me objekt: "Për kryerjen e disa ndryshimeve në vendim të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së 207 datë 25.09.2023 "Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'" dhe Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 200 datë 01.07.2025 (Nr. 2322 prot. Datë 01.07.2025) me objekt "Për saktësim në vendim të BA-së nr. 140 datë 28.04.2025 dhe vendimit të BA-së nr. 220 datë 29.09.2023 dhe vendimit të SA-së nr. 207 datë 25.09.2023 Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", dhe Udhëzuesit nr. _____ datë ___/___/2026 me objekt "Udhëzues për procedurën e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të financimit të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", kërkoj rimbursimin e shpenzimeve të botimit të artikullit **"*Titulli i artikullit*"** me kod DOI ***kodi*** të botuar në revistën **"*Emri i plotë i revistës*"** që botohet në ***Qyteti (Shteti)*** nga ***Emri i institucionit qe e boton***. Për botimin në këtë revistë nevojitet mbulimi nga USH-ja i një shpenzimi prej ***shuma e shpenzimit dhe monedha***.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Titulli. Grada. Emri Mbiemri

Pedagog pranë Departamentit të ***Emri i departamentit***

Fakulteti i ***Emri i Fakultetit***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I EMRI I FAKULTETIT

Shkodër, më _____

Lënda: Relacion për mbarëvajtjen e pjesëmarrjes në konferencën/kongresin/simpoziomin
“* Akronimi i konferencës *”

TITULLI/GRADA EMRI MBIEMRI

DEKAN

FAKULTETI I *EMRI I FAKULTETIT*

Bazuar në Udhëzuesin Nr. _____ datë ____/____/2026 me objekt “Udhëzues mbi procedurën e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të financimit të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’” dhe detyrimeve që lindin për paraqitjen pranë njësisë kryesore brenda 2 javëve pas pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium të një relacioni, ju lutem gjeni në vijim një relacion mbi pjesëmarrjen në konferencë/kongres/simpozium:

Titulli i konferencës/kongresit/simpoziumit:

Institucioni që e organizon konferencën/kongresin/simpoziumin:

Vendi ku u mbajt konferenca/kongresi/simpoziumi:

Data kur u mbajt konferenca/kongresi/simpoziumi:

Titulli i prezantimit të mbajtur:

Autorë të prezantimit:

Detaje në lidhje me mbarëvajtjen e konferencës/kongresit/simpoziumit:

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Titulli. Grada. Emri Mbiemri

Pedagog pranë Departamentit të *Emri i departamentit*

Fakulteti i *Emri i Fakultetit*



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I EMRI I FAKULTETIT

Shkodër, më ____ . ____ . ____

Lënda: Kërkesë për rimbursim të shpenzimeve të pjesëmarrjes në konferencën/kongresin/simpoziumin "***Akronimi i konferencës/kongresit/simpoziomit***"

TITULLI/GRADA EMRI MBIEMRI
DEKAN
FAKULTETI I *EMRI I FAKULTETIT*

Bazuar në Udhëzuesin Nr. [] datë [] / [] /2025 me objekt "Udhëzues mbi procedurën e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të financimit të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", kërkoj rimbursimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes time në konferencën/kongresin/simpoziumin "***Titulli i plotë i konferencës /kongresit/simpoziomit***" të organizuar nga ***Emri i institucionit*** me datë ***DD.MM.VVVV*** në ***Qyteti (Shteti)*** ku kam mbajtur prezantimin "***Titulli i prezantimit***". Bashkëngjitur kësaj kërkesë gjendet:

1. Skeda e rimbursimit të pjesëmarrjes në konferenca
2. Dokumentacioni mbështetës

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Titulli. Grada. Emri Mbiemri
Pedagog pranë Departamentit të ***Emri i departamentit***
Fakulteti i ***Emri i Fakultetit***

Nr	SKEDA E RIMBURSIMIT TË PJESËMARRJEVE NË KONFERENCA /KONGRESE/SIMPOZIUME	
1	Emri dhe mbiemri i pedagogut	
2	Grada/Titulli	
3	Fakulteti	
4	Departamenti	
5	Pedagog me kohë të plotë që prej	
6	Titulli i konferencës/kongresit/simpoziumit	
7	Data e konferencës/kongresit/simpoziumit	
8	Qyteti dhe shteti ku u mbajt konferenca /kongresi/simpoziumi	
9	Titulli i referimit të mbajtur	
10	Autorët e referimit	
11	Mënyra e pjesëmarrjes	<input type="checkbox"/> Fizikisht <input type="checkbox"/> Online
12	Ka paraqitur në dekanat brenda 2 javëve pas kthimit një relacion për pjesëmarrjen në konferencë/kongres/simpozium	<input type="checkbox"/> Po Nr _____ prot datë DD.MM.VVVV <input type="checkbox"/> Jo
13	Ka deklaruar USH-në si institucion përkatësie	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
14	Po përfiton aktualisht leje akademike	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
15	Versioni në shqip i abstraktit gjendet bashkëlidhur	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
16	Shuma totale e kërkuar për tu rimbursuar për këtë konferencë ⁴	

Titulli. Grada. Emri Mbiemri

Pedagog pranë Departamentit të *Emri i departamentit*

Fakulteti i *Emri i Fakultetit*

⁴ Shuma të shënohet në monedhën në të cilën është bërë pagesa

DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS

A.	Për tarifën e pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium	Dokumentacioni i dorëzuar bashkëlidhur kësaj shtojce ⁵		Shuma e kërkuar për rimbursim ⁶
1	Faturë për tarifën e pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium ⁷	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	
2	Transfertë/Urdhër pagesë për tarifën e pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium ⁸	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
3	Nxjerrje llogarie (<i>Statement</i> nga banka) ⁹	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
4	<i>Screenshot</i> i pagesës ¹⁰	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
B.	Për udhëtimin	Dokumentacioni i dorëzuar bashkëngjitur kësaj shtojce		Shuma e kërkuar për rimbursim
1	<i>Boarding pass</i> ¹¹	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
2	Biletë autobusi	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	
3	Biletë treni	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	
C.	Për akomodimin	Dokumentacioni i dorëzuar bashkëngjitur kësaj shtojce		Shuma e kërkuar për rimbursim
1	Faturë hoteli ¹²	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	
2	Transfertë/Urdhër pagesë ¹³	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A

⁵ Të gjithë dokumentet e deklaruara me "Po" në këtë kolonë duhet të dorëzohen bashkëngjitur kësaj shtojce sipas renditjes në këtë shtojcë

⁶ Çdo shumë në këtë kolonë të shënohet në monedhën në të cilën është bërë pagesa

⁷ Çdo faturë duhet të jetë e firmosur dhe vulosur nga institucioni që e lëshon

⁸ Ky dokument nuk kërkohet kur pagesa e faturës bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/krediti)

⁹ Ky dokument kërkohet kur pagesa bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/krediti) dhe përmes tij vërtetohet që fatura është paguar nga ana e pedagogut. Çdo pagesë e realizuar, me apo pa faturë, duhet që gjithmonë të shoqërohet me një transfertë/urdhërpagesë, nxjerrje llogarie ose *screenshot* të konfirmimit të pagesës me firmë dhe vulë të njomë të bankës.

¹⁰ Ky dokument mund të dorëzohet kur pagesa është realizuar përmes *paypal* (me kartë krediti/debiti) dhe aplikuesi nuk dorëzon dot një *statement* bankar. Dokumenti merr vlefshmëri vetëm nëse është me firmë dhe vulë të njomë nga banka.

¹¹ Fatura e biletës duhet të shoqërohet gjithmonë me *boarding pass* që të quhet legjitime për rimbursim.

¹² Bazuar në Vendimin Nr. 870 Date 14.12.2011 "Per trajtimin financiar te punonjesve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" kategoria e hotelit duhet të jetë jo më shumë se me 3 yje.

¹³ E vlefshme kur pagesa bëhet përmes kartë krediti/debiti, në rastin kur pagesa bëhet dorazi mjafton fatura e vulosur ose me barkod dhe dokumenti i kasës (nëse aplikohet).

SHTOJCA 4

3	Nxjerrje llogarie (<i>Statement</i> nga banka) ¹⁴	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
D	Për vërtetimin e pjesëmarrjes në konferencë/kongres/simpozium	Dokumentacioni i dorëzuar bashkëngjitur kësaj shtojce		Shuma e kërkuar për rimbursim
1	Dokumente që vërtetojnë pjesëmarrjen në konferencë/kongres/simpozium ¹⁵	Certifikate	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A
		Listë-prezencë	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A
		Programi	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A
2	Tabela e përmbajtjes e <i>proceedings</i>	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
3	Faqet e artikullit në <i>proceedings</i>	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
4	Tabela e përmbajtjes e librit të abstrakteve ¹⁶	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
5	Faqet e botimit në librin e abstrakteve ku gjendet USH-ja si institucion përkatës ¹⁷	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A
6	Programi dhe PPT i prezantimit ku gjendet USH-ja si institucion përkatës ¹⁸	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	N/A

Titulli. Grada. Emri Mbiemri

Pedagog pranë Departamentit të ***Emri i departamentit***

Fakulteti i ***Emri i Fakultetit***

¹⁴ Ky dokument kërkohet kur pagesa bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/krediti) dhe përmes tij vërtetohet që fatura është paguar nga ana e pedagogut. Çdo pagesë e realizuar, me apo pa fakturë, për tu konsideruar legjitime duhet që gjithmonë të shoqërohet me një transfertë/urdhërpagesë, nxjerrje llogarie ose *screenshot* të konfirmimit të pagesës me firmë dhe vulë të njomë të bankës.

¹⁵ Duhet të paraqitet të paktën një nga këto dokumente që vërteton praninë në konferencë/kongres/simpozium

¹⁶ Dorëzohet në rast se konferenca nuk ka *proceedings* atëherë dorëzohet libri i abstrakteve.

¹⁷ Që një botim të konsiderohet legjitim për rimbursim duhet që ai të përmbajë gjithmonë të listuar si institucion përkatës Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Për arsye unifikimi preferohet që të përdoret emërtimi: University of Shkodra "Luigj Gurakuqi". Institucioni i përkatësisë duhet të jetë me patjetër tek njëri nga dokumentet e dorëzuara: *Proceedings*, libri i abstrakteve ose programi i shoqëruar me PPT e prezantimit.

¹⁸ Dorëzohet në rast se konferenca nuk ka as *proceedings* dhe as librin e abstrakteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I EMRI I FAKULTETIT

Shkodër, më ____ . ____ . ____

Lënda: Kërkesë për rimbursim të shpenzimeve të botimit në Revistën "***Akronimi i revistës***"

TITULLI/GRADA EMRI MBIEMRI

DEKAN,

FAKULTETI I ***EMRI I FAKULTETIT***

Bazuar në Udhëzuesin nr. ____ datë ____ / ____ /2026 me objekt "Udhëzues mbi procedurën e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të financimit të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi'", kërkoj rimbursimin e shpenzimeve të botimit të artikullit "***Titulli i plotë i artikullit***" në revistën shkencore "***Titulli i plotë i revistës (akronimi)***". Bashkëngjitur kësaj kërkesë gjendet:

1. Skeda e rimbursimit të shpenzimeve të botimit
2. Dokumentacioni mbështetës

Duke ju falnderuar për bashkëpunimin,

Titulli. Grada. Emri Mbiemri

Pedagog pranë Departamentit të ***Emri i departamentit***

Fakulteti i ***Emri i Fakultetit***

Nr	SKEDA E RIMBURSIMIT TË SHPENZIMEVE TË BOTIMIT	
1	Emri dhe mbiemri i pedagogut	
2	Grada/Titulli	
3	Fakulteti	
4	Departamenti	
5	Pedagog me kohë të plotë që prej	
6	Emri i revistës	
7	Shteti ku botohet revista	
8	Titulli i artikullit	
9	Data e pranimit të artikullit	
10	Data e botimit të artikullit	
11	Autorët e artikullit	
12	DOI	
13	Ka deklaruar në artikull USH-në si institucion përkatësie (<i>affiliation</i>)	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
14	Po përfiton aktualisht leje akademike	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
15	Versioni në shqip i abstraktit gjendet bashkëlidhur	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
16	Shuma totale e kërkuar për t'u rimbursuar për këtë botim ¹⁹	

Titulli. Grada. Emri Mbiemri
 Pedagog pranë Departamentit të ***Emri i departamentit***
 Fakulteti i ***Emri i Fakultetit***

¹⁹ Shuma të shënohet në monedhën në të cilën është bërë pagesa

DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS

A.	Për tarifën e botimit në revistë	Dokumentacioni i dorëzuar bashkëngjitur kësaj shtojce ²⁰	Shuma e kërkuar për rimbursim ²¹
1	Faturë për tarifën e botimit ²²	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	
2	Transfertë/Urdhër pagesë për tarifën e botimit ²³	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A
3	Nxjerrje llogarie (Statement nga banka) ²⁴	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A
4	Screenshot i pagesës ²⁵	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A
B	Për vërtetimin e botimit	Dokumentacioni i dorëzuar bashkëngjitur kësaj shtojce	Shuma e kërkuar për rimbursim
1	Kopertina dhe tabela e përmbajtjes e numrit të revistës ku gjendet artikulli	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> N/A	N/A
2	Faqet e plota të artikullit në revistë	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A
3	Faqet e botimit ku gjendet edhe USH-ja si institucion përkatësie ²⁶	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	N/A

Titulli, Grada, Emri Mbiemri

Pedagog pranë Departamentit të *Emri i departamentit*

Fakulteti i *Emri i Fakultetit*

²⁰ Të gjithë dokumentet e deklaruara me "Po" në këtë kolonë duhet të dorëzohen bashkëngjitur kësaj shtojce sipas renditjes në këtë shtojcë

²¹ Çdo shumë në këtë kolonë të shënohet në monedhën në të cilën është bërë pagesa sipas formatit: p.sh. 10,250.00 Lek/Euro/USD.

²² Çdo faturë duhet të jetë e firmosur dhe vulosur nga institucioni që e lëshon

²³ Ky dokument nuk është i nevojshëm kur pagesa e faturës bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/krediti)

²⁴ Ky dokument kërkohet sidomos kur pagesa bëhet në *paypal* (përmes një karte debiti/krediti) dhe përmes tij vërtetohet që fatura është shlyer nga ana e pedagogut. Çdo pagesë e realizuar, me apo pa faturë, duhet që gjithmonë të shoqërohet me një urdhërpagesë ose një nxjerrje llogarie.

²⁵ Ky dokument mund të dorëzohet kur pagesa është realizuar përmes *paypal* (me kartë krediti/debiti) dhe aplikuesi nuk dorëzon dot një statement bankar. Dokumenti merr vlefshmëri vetëm nëse është me firmë dhe vulë të njomë nga banka.

²⁶ Që një botim të konsiderohet legjitim për rimbursim duhet që ai të përmbajë gjithmonë të listuar si institucion përkatësie Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Për arsye unifikimi preferohet që të përdoret emërtimi: University of Shkodra "Luigj Gurakuqi".



Shkodër, më _____

Lënda: Përmbledhëse e fondit të përdorur nga *akronimi i njësisë kryesore* për periudhën xxxxxxxx

Tab 1: Përmbledhëse për rimbursimin për pjesëmarrje në konferenca

Nr	Emri dhe Mbiemri i Pedagogut	Njësia bazë	Shuma totale e kërkuar për rimbursim	
			Konferencë e zhvilluar në Shqipëri ose rajon*	Konferencë e zhvilluar në Vendet e BE ose OECD
1			ALL -	ALL -
2			ALL -	ALL -
Totali			ALL -	ALL -

*Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Mali i Zi

Tab 2: Përmbledhëse për rimbursimin për botime në revista

Nr	Emri dhe Mbiemri i Pedagogut	Njësia bazë	Shuma totale e kërkuar për rimbursim	
			Botime në Shqipëri ose rajon*	Botime në Vendet e BE ose OECD
1			ALL -	ALL -
2			ALL -	ALL -
Totali			ALL -	ALL -

*Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Mali i Zi

Tab 3: Shuma totale e raportuar për periudhën xxxxxxxxxxxx për akronimi i njësisë kryesore

Shuma totale e fondit për Njësine Kryesore	ALL	Kontroll: Shuma e mbetur për tu përdorur/pa përdorur
Shuma totale në dispozicion për konferenca dhe botime në Shqipëri ose rajon	ALL	ALL 0.00
Shuma totale në dispozicion për konferenca dhe botime në vendet e BE dhe OECD	ALL	ALL 0.00